



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2005/20, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 29 Prill 2005, mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 të dates 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 20 të Rregullores së UNMIK-ut me 2005/20 (Rregullorja e Pensionit), në përshkrimin e rregullave dhe procedurave për ndërprejen e Pensioneve Pundhënëse Suplementare,

Bordi Drejtues i Autoritetit bankar të pagesave të Kosovës, në mbledhjen e tij të mbajtur më 16 Mars 2006 miraton si vijon:

Rregulla 21 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Shuarjen e Fondit të Pensionit të dates 23 Tetor 2002

Neni 1

Sfera dhe qëllimi i Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet Fondit të Pensionit Pundhënës Suplementar (Fondi i Pensionit), organeve drejtuese të Pundhënësit, organeve drejtuese të Fondit të Pensionit dhe Menagjerit Special të emruar nga BPK-ja në pajtim me këtë Rregull.

1.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregull parashkruan udhizimet dhe kërkesat që duhet të plotsohen gjatë shuarjes së Fondit të Pensionit, detyrat e Sponzorit, bordit drejtues të Fondit të Pensionit dhe Menagjerit Special të emruar nga BPK-ja që të zhvilloj likuidimin dhe distribuimin e mjeteve të pensioneve. Kjo Rregull kërkon që të mbrojnë pjesmarrësit në rastë se Fondi i Pensionit shuhet. Përveq kësaj, kjo rregull i adresohet ndërprerjes së Fondit të Pensionit që është themeluar para datës efektive të rregullores, dhe nuk është licensuar kurrë, dhe sigurojnë pensione të pa autorizuara.

Neni 2

Dispozitat e përgjithsme

2.1 Definimi

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar në Rregulloren e Pensioneve dhe/ose definuar më tutje në këtë Rregull.

“Veprimet detyruese”, në këtë Rregull, nënkupton urdhërin ose direktivën e BPK-s në lidhje me pezullimin ose mohimin e licensës së Fondit të Pensionit dhe/ose shuarjen e Fondit të Pensionit. Termi përfshinë urdhërat dhe direktivat e BPK-s në lidhje me licensimin e pensioneve të pa autorizuar dhe/ose urdhërin e saj që ti ndërprejë pensionet e tilla të pa autorizuar.

“Shuarja jovullnetare” i referohet shuarjes së Fondit të Pensionit ose rregullimeve pensionale të pa autorizuar që rezultojnë nga masat e detyrueshme të BPK-s në pajtim me dispozitat e Rregullores së Pensionit dhe kjo Rregull.

“Menagjeri Special” nënkupton individin ose personin e emruar nga BPK-ja që të administrojë dhe menagjojë Fondin e Pensionit në likuidim.

“Shuarja me veprimin e ligjit” i referohet kushteve ku Fondi i Pensionit është shuar për shkak të likuidimit ose bankrotimit të Pundhënësit sponsorues.

“Shuarja vullnetare” i referohet shuarjes së Fondit të Pensionit që është inicuar me njohtim me shkrim të bërë nga bordi drejtues i Fondit të Pensionit për pjesmarrësit dhe BPK-n.

“Pensionet e pa autorizuar” i referohen disa ose të gjitha Rregullimeve Pensionale, duke përfshirë ato që kanë ekzistuar në kohën kur Rregullorja e Pensionit ka hyrë në fuqi, që zhvillohen nga ndonjë Pundhënës ose ndonjë person fizik ose person ligjor pa licensë të Fondit valid të Pensionit ose të Siguruesit të Pensionit të lëshuar nga BPK-ja.

2.2 Faktori Rregullator në shuarjen e Fondit të Pensionit

Rregullorja e Pensionit dhe këto Rregulla e ndihmojnë rritjen dhe zgjerimin e qdo Fondi të Pensionit, dhe sigurojnë se veprimet e detyrueshme që rezultojnë në shuarjen e Fondit të Pensionit janë ndërmarrë vetëm kur ka qenë e nevojshme për të mbrojtur interesat e pjesmarrësve dhe përfituesve.

Për tu shuar Fondi Pensional, duhet të zbatohen kushtet e shuarjes si në vijim:

- a). Në rastë të shuarjes vullnetare, bordi drejtues i Fondit të Pensionit duhet të kënaq BPK-n se plani i ndërprerjes do të mbrojë interesat e pjesmarrësve në mjetet e pensionit.
- b). Në rastë të shuarjes me veprimin e ligjit, bordi drejtues i Fondit të Pensionit dhe Pundhënësi duhet të jenë përshtatur me obligimet e tyre fiduciare për njohtimin me kohë të pjesmarrësve për likuidimin ose bankrotimin e Pundhënësit.
- c). Në rastë të shuarjes jovullnetare, BPK-ja duhet të zbatojë kërkesat e njohtimit paraprak, veq nëse interesi i pjesmarrësve është në rrezik të menjëhershëm, duke i lejuar trupave drejtues të Fondit të Pensionit:
 1. Kohë të mjaftueshme për të sanuar devijimet, thyerjet ose shkeljet që përbëjnë bazat për veprimet detyruese.
 2. Njohtimi I duhur mbi veprimet detyruese.
 3. Mundësia që të miratohen procedurat që mbrojnë interesat e pjesmarrësve dhe përfituesve të Fondit të Pensionit.

4. Shërbimet profesionale të Menagjerit Special, nëse është e nevojshme, që të administroj dhe menagjoj Fondin e Pensionit në likuidim në mënyrë që:

(i) Të ofrojë për një likuidim të lehtë dhe distribuim të mjeteve të pensionit për pjesmarrësit dhe përfituesit.

(ii) Distribuj mjetet e pensionit të pjesmarrësve të siguruesi tjetër i pensionit, nëse titullimi i pensionit nuk pritet ende.

5. Procedurat e ndërprerjes jo vullnetare duhet të zbatohen kur një Pundhënës duke siguruar pensione të pa autorizuara nuk aplikon për licensë ose edhe aplikimi për licensë ka dështuar për të fituar licensën në pajtim me rregulloren e aplikueshme dhe Rregullat.

Neni 3

Shuarja e Pensionit Pundhënës Suplementar

3.1 Anulimi i licensës së Fondit të Pensionit

BPK-ja duhet të anuloj licensën në rrethanat si vijojnë:

a. Kapitulumin vullnetar i licensës. Në kapitulumin vullnetar të licensës së Fondit të Pensionit, duhet të përmbushen kërkesat si vijojnë:

1. Bordi i drejtorëve të Fondit të Pensionit do të pyesin BPK-n, me njohtim me shkrim, për shuarjen e Fondit të Pensionit, duke specifikuar arsyet për këtë, dhe kapitulumin e licensës së Fondit të Pensionit.

2. Njohtimi me shkrim për këtë shuarje vullnetare i është dërguar të gjithë pjesmarrësve dhe BPK-s, 90 ditë para datës së menduar për shuarjen.

3. Menjëherë pas këtij njohtimi me shkrim, Bordi i Drejtorëve duhet të përgatis vlersimin e mjeteve të pensionit dhe ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mrojtur interesat e pjesmarrësve dhe përfituesve.

4. Në lirinë e saj të veprimit, në mënyrë që të mundsojë mjetet më të mirë të mundshme të mbrojtjes së interesit të pjesmarrësve dhe përfituesve, BPK mund të lëshojë një urdhër që të ngrijë mjetet e Fondit të Pensionit; ose anuloj licensën e saj, ose të dyjat, dhe të caktojë menagjer special për të menagjuar mjetet e pensionit në pajtim me procedurat e sqaruara në nenin 4 të kësaj Rregulle.

b. Me veprimin e ligjit. Licenca e Pensionit është anuluar nga BPK pa pasur nevojë për njohtim paraprak, urdhër apo direktiv kur Pundhënësi Sponzorues është likuiduar ose deklaruar i bankrotuar. Në mënyrë që të sigurohet mbrotjen më të mirë të mundshme të intersave të pjesmarrësve dhe përfituesve BPK-ja duhet:

1. Menjëherë të lëshojë një urdhër që të ngrijë mjetet e pensionit dhe anuloj licensën e Fondit të Pensionit dhe

2. Të caktohet menagjeri special në pajtim me Nenin 4 të kësaj Rregulle.

b. Anulimi jovullnetar. BPK ndërmerr veprime detyruese specifike për të anuluar licensën e Fondit të Pensionit bazuar në kriteret e specifikuar në Rregulloren e Pensionit dhe Rregullën 1. Anulimi i Fondit të Pensionit duhet të shfrytzojë procedurat si vijojnë:

1. Njohtimi. Në rastet kur BPK-ja anulon licensën e Fondit të Pensionit:

(i) Njohtimi me shkrim jo më pak se 30 ditë para datës së menduar për anulim duhet të dërgohet bordit të drejtorëve të Fondit të Pensionit dhe Sponzorit(ve).

(ii) Njohtimi duhet qartë të tregojë bazat e anulimit.

(iii) Njohtimi duhet ti jep bordit të drejtorëve jo më heret se 30 ditë që të tregojnë shkakun që urdhëri për anulim nuk duhet të lëshohet.

(iv) Brenda periodës prej 30 ditësh prej pranimi të njohtimit, bordi i drejtorëve të Fondit të Pensionit dorzon planin e përshtatjes me shkrim për të larguar bazat në të cilat është bazuar anulimi.

(v) Nëse BPK-ja është e kënaqur me planin e përshtatshmërisë, urdhëri për anulim, nëse një veq është lëshuar, është hjekur dhe licenca është restauruar varsishtë prej disa restriksioneve, kufizimeve ose kushteve që BPK-ja mund ti kërkojë.

(vi) Nëse Bordi i drejtorëve dështon që të dorzoj planin e përshtatshmërisë brenda numrit të specifikuar të ditëve, ose nëse BPK-ja nuk është e kënaqur me planin e përshtatshmërisë që i është dorzuar nga bordi i drejtorëve, BPK-ja mund të vazhdojë të anuloj licensën e fondit të pensionit dhe të ndërmerr veprime tjera detyruese dhe të urdhërojë shuarjen e Fondit të pensionit në pajtim me këtë Rregull.

3.2 Veprimet e detyruara

Pas anulimit të licensës së Fondit të Pensionit, ose lëshimi të urdhërit për ndërprerjen e rregullimeve të pensioneve të pa autorizuar, BPK-ja duhet të ndërmarrë veprimet e detyrueshme si në vijim:

a) Lëshimi dhe dërgimi i “urdhërit për ngrirje” për mjetet e pensionit, ose bërja e “urdhërit të ngrirë “ të mëhershëm si permanent , Kujdestarit dhe Menagjerit(Ve) të Mjeteve ose Deponuesve të mjeteve të pensionit duke përfshirë kopjen e urdhërit të anulimit ose ndërprerjes.

b) Lëshimi i urdhërit për organet drejtuese të Fondit të Pensionit ose për sponsorët ose administratorët e rregullimeve pensionale të pa autorizuar për ndërprerjen dhe pushimin e pranimi të kontributeve të pensionit dhe kontraktimit dhe pagesës së titullimeve të reja ose ekzistuese të pensionit.

c) Urdhëroj shuarjen e Fondit të Pensionit ose rregullimeve pensionale të pa autorizuar dhe likuidimin e mjeteve të pensionit në pajtim me nenin 4 të kësaj Rregulle.

d) Emrimi i Menagjerit të kualifikuar Special që të menagjoj mjetet e pensionit që të arrihet distribuimi më I mirë i mjeteve për pjesmarrësit dhe përfituesit.

e) Të urdhërohen organet drejtuese të Fondit të Pensionit ose sponsoruesi ose administratori i rregullimeve pensionale të pa autorizuar që të transmetoj te menagjeri special (ose në BPK) të gjitha shënimet dhe dokumentet që ju takojnë mjeteve të pensionit brenda afatit kohor dhe duke aplikuar procedurat e aplikueshme të rregulluara më herët në Urdhëresën e Pensionit, ose Marrveshjen për të siguruar pensionet, për derisa BPK-ja për interesin e pjesmarrësve dhe përfituesve, urdhëron një kohë më të herëshme ose mënyrë tjetër që të kryej atë transmision.

Neni 4

Procedurat për shuarjen e Fondit Pensional ose pensioneve të pa autorizuar

4.1 Menagjeri Special

Në lirinë e saj të veprimit, BPK-ja mund të emrojë Menagjerin Special që të administroj dhe menagjoj mjetet e pensionit të Fondit të Pensionit që është shuar. Sido që të jetë, në

rastë të shuarjes jovullnetare BPK-ja duhet të emroj Menagjerin Special. Menagjeri special është:

- a).Personi me kualifikimet dhe njohuritë e duhura profesionale, trajnim dhe përvojë në pensione ose në menagjimin ose administrimin e mjeteve dhe i cili i ka kaluar testet dhe standardet se është “i gatshëm dhe i duhur”, të miratuara nga BPK që të zbatojë për antarin e bordit drejtues të Fondit të Pensionit.
- b).Nuk mundet me qenë ndonjë person i bashkuar i Pundhënësit ose ndonjë organizatë e puntorëve që përfaqson punëtorët e Pundhënësit, ose ndonjë antarë i trupit drejtues të Fondit të Pensionit ose Pundhënësi ose ndonjë puntorë, ose antarë i trupit derjtues të ndonjë organizate të puntorëve që përfaqson Të Punsuarit e Pundhënësit.
- c).Personi i cili pranon detyrat dhe përgjegjësitë për administrimin dhe menagjimin e mjeteve të pensionit si fiduciare për pjesmarrësit dhe përfituesit.
- d).Kompensuar nga mjetet e pensionit për shërbimet e tij;vlera e një kompensimi të tillë duhet të caktohet dhe aprovohet nga BPK-ja.
- e).BPK-ja duhet të zhvilloj dhe mirmbaj listën e personave të kualifikuar që shërbejnë si Menagjer Special dhe duhet të sigurojnë për procedurat në mënyrë që personat mundë të aplikojnë që të shtohen në një listë të tillë. Informatat që gjenden në listë duhet të përfshijnë emrat, profesionin, kualifikimin, dhe metodat e propozuara për llogaritjen e kompensimit të individve që shërbejnë si Menagjer Special.

4.2 Shuarja (likuidimi) e Fondit të Pensionit ose Pensioneve të Pa autorizuara

Procedurat dhe kërkesat për shuarjen e Fondit të Pensionit ose pensioneve të pa autorizuara duhet të sigurojnë mbrojtjen më të mirë të mundshme të interesave të pjesmarrësve dhe përfituesve. Në shuarjen e Fondit të Pensionit ose pensioneve të pa autorizuara duhet të zbatohen udhizimet si vijojnë:

a)Shuarja nga Menagjeri Special

1.Likuidimi dhe distribuimi i mjeteve të pensionit duhet të bazohet në planin për likuidim të aprovuar nga BPK-ja.

2.Menagjeri Special e sjell në BPK planin për likuidim. Plani duhet të përmbajë detalet si vijojnë:

(i).Datën ose numrin e ditëve, duke mos e tejkaluar një vit, gjatë së cilës kohë kryhet likuidimi.

(ii).Raportin e të drejtave të ligjshme të pjesmarrësve.

(iii).Mënyra në të cilën mjetet janë të predispozuara dhe arsytimi.

(iv).Koha dhe mënyra e distribuimit të mjeteve të pensionit për pjesmarrësit dhe përfituesit në një rregullim pensional alternativ dhe arsytimi.

(v).Afatet kohore ku mjetet specifike janë të predispozuara dhe justifikimi për atë afat kohor.

(vi).Vlera e pritur vazhdon ashtu që ndodhë që është realizuar prej dispozicionit të mjeteve.

(vii).Në rastë të rregullimeve pensionale të pa autorizuara që nuk janë të financuara dhe nuk ka mjete të pensionit, plani i pundhënësit për plotsimin e kërkesave për të paguar të drejtat e ligjshme të pjesmarrësit , në pajtim me Rregulloren, ose nëpërmes të financimit të obligimeve ose nëpërmes të blerjes së pensioneve individuale suplementare.

(viii). Taksa e propozuar për menagjerin special.

3. Plani për likuidim është rishikuar nga BPK-ja dhe brenda periodës prej 30 ditësh, nëse është e pranueshme, aprovon planin varsisht prej rezultateve të caktuara ose treguesve të kryerjes që vlerësojnë ose validizojnë planin kohë pas kohe.

4. Nëse BPK-ja refuzon planin për likuidim, Menagjeri Special duhet të parashtojë në BPK një plan tjetër, brenda periodës prej 90 ditëve.

5. Brenda 90 ditësh të emrimit të asaj/atij, Menagjeri Special duhet:

(i). të bëjë vlersimin e mjeteve të pensionit.

(ii). Të gjurmoj kërkesat ndaj palës së tretë, dhe

(iii). Të rregulloj detyrimet legjitime të Fondit të Pensionit

(iv). Të Parashtojë në BPK rezymenë e vlersimit dhe deklaratën preliminare të vlerave për secilin pjesmarrës individual.

6. Nëse kontabiliteti i mjeteve tregon se ka mjaft mjete likuide për tu bërë pagesat e plota për të gjitha bilanci e individëve, Menagjeri Special njohton pjesmarrësit për mundësitë e tyre që menjëherë të transferojnë bilanci e llogarive të tyre në Fond tjetër të Pensionit ose të Siguruesi i Pensionit. Perioda brenda së cilës duhet të ushtrohet kjo mundësi duhet të tregohet në njohtim.

7. Menagjeri special gjurmon të gjitha kërkesat legjitime në emër të Fondit të Pensionit, duke përfshirë ndonjë kontribut të Pundhënësit.

8. Pa aprovim paraprak me shkrim të BPK-s nuk mund të bëhen distribuime të pjesrëshme ose të përkohshme për pjesmarrësit individual, të pensionuarit dhe përfituesit.

9. Menagjeri special parashtron në BPK raportin për gjendjen e likuidimit qdo interval prej 180 ditësh ose edhe më shpesh nëse e kërkon BPK-ja.

10. Gjatë periodës së likuidimit dhe para distribuimit ose transferit të mjeteve të pensionit në Fond tjetër pensional ose Sigurues të pensionit, menagjeri special ka fuqi të plotë dhe autoritet që të menagjoj mjetet e pensionit dhe mundë të mbajnë ose të largojnë qdo menagjer të mjeteve ose kujdestar, ose të emrojnë të ritë në vend të tyre.

11. Të gjitha distribuimet e mjeteve të pensioneve janë bërë në pajtim me termet dhe kushtet në planin e aprovuar të likuidimit. Gjatë distribuimit, menagjeri special vërteton në BPK, vlerën, kohën dhe mënyrën e distribuimeve të tilla.

12. Distribuimi i mjeteve të pensionit mund të bëhet vetëm me transferimin e vlerave për pjesmarrësit individual në Fond tjetër të Pensionit ose të Siguruesi i pensionit në pajtim me dispozitat e Rregullës 20 të këtyre Rregullave.

13. Brenda periodës prej 30 ditësh para kryerjes së transferit të vlerave të pjesmarrësve, menagjeri special njohton të gjithë pjesmarrësit dhe përfituesit me vlerën finale, kohën dhe mënyrën e distribuimit dhe transferit të mjeteve të pensionit.

14. Transferi i mjeteve të pensionit sikur që është përshkruar më lartë, duke përcjellur kërkesat e Rregullës 20, shuan Fondin e Pensionit.

15. Qdo rregullim pensional I pa autorizuar shuhet në datën që BPK-ja e ka dërguar për shuarje. Mjetet pensionale likuidohen në pajtim me planin e likuidimit të dorzuar nga Menagjeri Special dhe aprovimin e BPK-s.

b. Shuarja nga Bordi i Drejtorëve të Fondit të Pensionit

1. Bordi i drejtorëve të Fondit të Pensionit njohton të gjithë pjesmarrësit, përfituesit dhe BPK-n për qëllimin e shuarjes së Fondit të Pensionit.

- 2.Njohtimi duhet ti dërgohet së paku 90 ditë para datës së caktuar për shuarje të fondit.
- 3.Brenda 90 ditësh të njohtimit bordi i drejtorëve duhet të përgatis një kontabilitet të fondit të pensionit duke paraqitur të gjitha mjetet e tij dhe detyrimet dhe pasqyren preliminare të vlerave të pjesmarrësve dhe përfituesve dhe të dorzon një kopje të këtyre raporteve të të gjithë pjesmarrësit dhe përfituesit si dhe në BPK.
- 4.Nëse kontabiliteti tregon mjete likuide të mjaftueshme për të bërë pagesat e plota për të gjitha “drejtat e rezervuara”(“vested rights”), pjesmarrësit duhet të njohtohen me të drejtat e tyre që menjëherë të transferojnë bilancet e tyre në Fond tjetër Pensional ose në Siguruesin tjetër të Pensionit.
- 5.Nëse ka mjete likuide të pamjaftueshme për tu bërë pagesat e plota për të drejtat e rezervuara, bordi i drejtorëve duhet të parashtror propozimin për likuidim për aprovim nga BPK-ja. Propozimi duhet gjithashtu ti dërgohet të gjithë pjesmarrësve dhe përfituesve.
- 6.Propozimi për likuidim duhet të jetë në formë dhe substancë sikur që kërkohet nga menagjeri special me kërkesat e shtuara që përfshijnë sqarimin për të gjitha përpjekjet e bëra ose që duhet të bëhen për të mbledhur kontributet nga Pundhënësi sponsorues dhe kërkesat tjera të Fondit të Pensionit.
- 7.BPK-ja mundë të aprovojë ose refuzoj propozimin për likuidim brenda 30 ditësh prej datës që është parashtruar.
- 8.Nëse propozimi për likuidim është refuzuar, BPK-ja mundë të kërkojë nga Bordi që të parashtror një propozim tjetër ose mundë të urdhërojë menagjerin special që të likuidoj Fondin e Pensionit dhe pastaj të vazhdojë në pajtim me nën-nenin 4a) më lartë.
- 9.Likuidimi dhe distribuimi i mjeteve të pensionit duhet të bëhet në pajtim me planin e aprovuar për likuidim.
- 10.Gjatë periodës së likuidimit dhe para distribuimit të mjeteve, bordi i drejtorëve mbetet që të ketë influencë të plotë të administrimit për mjetet e pensionit.
- 11.Të gjitha shpërndarjet e mjeteve të pensionit duhet të bëhen vetëm me transferimin e vlerave për pjesmarrësit individual për në Fond tjetër të Pensionit ose në Sigurues të Pensionit, në pajtueshmëri me Rregullën 20 të këtyre Rregullave.
- 12.Bordi i drejtorëve njohton të gjithë pjesmarrësit dhe përfituesit me vlerat finale, kohën dhe mënyrën e distribuimit. Nuk mundë të bëhet asnjë distribuim ose transfer i pagesave deri pas datës së skadimit prej 30 ditësh prej datës së njohtimit.
- 13.Distribuimi i mjeteve me transfer direct të bilancit individual në Fondin e ri të Pensionit të pjesmarrësve ose Siguruesit të Pensionit, të bërë në pajtim me Rregullën 20 të këtyre Rregullave, shuan Fondin e Pensionit.

Neni 5

Fondet e pamjaftueshme për të paguar të drejtat e ligjshme

- 5.1 Nëse Fondi Pensional ka fonde të pamjaftueshme për të paguar të drejtat e ligjshme,dhe nëse Menagjeri special ka shterrur të gjitha mënyrat për mbledhjen e kontributeve të papaguara ose kërkesave tjera,Menagjeri special duhet të propozojë planin për pagesa të pjesërishme të të drejtave të ligjshme.
- 5.2 Menagheri special duhet të llogaris vlerën prezente të drejtave të ligjshme dhe të propozojë pagesa të pjesërishme për vlerat prezente të pjesmarrësve.

5.3 Pjesmarrësit të cilët veq janë duke marrur pensionin dhe kanë përmbushur moshën minimale të pensionit për Pensionin Bazik (65) duhet të kenë përparsi në këtë plan.

5.4 Entiteti Pensional që pranon transferin, në të cilin janë transferuar mjetet pensionale, nëse ky është rasti, nuk duhet të kenë detyrime për detyrimet e tilla të pafinancuara të të drejtave të ligjshme të Fondit Pensional që e bënë transferin.

Neni 6

Mungesa e fondeve të pensionit në të cilin mundë të transferohen mjetet e pensioneve

6.1 Nëse nuk ka Entitete pensionale të licensuara në të cilat mundë të transferohen Mjetet e pensionit pas shuarjes së Fondit pensional, Menagjeri Special duhet të propozojë procedurën për pagesat ndaj pjesmarrësve.

6.2 Pjesamrësit të cilët veq marrin pensionet dhe kanë plotësuar moshën minimale të pensionit për Pensionin Bazik (65) duhet të marrin pagesa në para të gatshme.

6.3 Pjesmarrësit të cilët veq marrin pensionin mirpo nuk përmbushin moshën minimale të pensionit për Pensionin Bazik (65) mundë të zgjedhin se a do të marrin pagesa në para të gatshme apo të transferojnë të drejtat e tyre të ligjshme në shkallën e pagesës në planin e propozuar të Trustit të Kursimeve pensionale të Kosovës.

6.4 Pjesmarrësit të cilët nuk marrin pensione dhe janë nën moshën e pensionit do të marrin transferin e të drejtave të tyre të ligjshme në shkallën e pagesës në planin e propozuar në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Neni 7

Të drejtat e pjesmarrësit në shuarjen e Fondit të Pensionit

7.1 Të drejtat e pjesmarrësve dhe përfituesve për të bërë ankesa

Pjesmarrësit e Fondit të Pensionit që është shuar kanë të drejtë që të paraqesin kërkesën ndaj bordit të drejtorëve të Fondit të Pensionit, Pundhënësit sponsorues, menagjerit të mjeteve dhe kujdestarit dhe/ose menagjerit special, ose ndonjë fiduciar ose pale të bashkuar të këtij entiteti, ndaj të cilit ai/a jo ose ata mundë të themelojnë shakun ose shkaqet e veprimeve. Për të zbatuar këtë të drejtë, pjesmarrësi ose pjesamrësit mundë të vazhdojnë me veprimet si vijojnë:

a. Pjesmarrësi (it) prezenton kërkesën e saj/atij në BPK për zgjidhje me fiduciarët e cituar të Fondit të Pensionit dhe mjeteve të tij.

b. Fajli i pjesmarrësit (ve) në veprim në gjyq (si psh. shkelja e detyrave fiduciare) ndaj ndonjerit ose të gjithë fiduciarëve të mjeteve të pensionit.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo rregull si e ndryshuar do të hyj në fuqi më 01 Prill 2006.

Michel Svetchine

Drejtori i përgjithshëm